



DËSHTON SEANCA E KONSTITUIMIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
PARTITË AKUZOJNË NJËRA-TJETRËN

KURTI VEÇ 52 VOTA, PO BLEN KOHË PËR T'I BËRË NUMRAT PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

FAÇE 4-5



Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën konstituive nuk e kanë votuar raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit, duke bërë kështu që kjo seancë të ndërpritet. Komisioni para deputetëve paraqiti raportin

dhe kërkoi që ai të votohej, me qëllim që të verifikoheshin mandatet 120 deputetëve të zgjedhur më 9 shkurt. Deputetët e LV-së dhe të Nismës kanë votuar për raportin. Kundër ishin ata të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së, ndërsa Lista Serbe abstenoj.

Kurti, duke i akuzuar tri partitë që nuk e votuan këtë raport, ka theksuar se kjo është situatë e paparë në shtetin tonë e shumë më gjerë, ndërkaj partitë politike PDK, LDK dhe AAK kanë theksuar se Kurti po blen kohë, sepse nuk i ka votat për formimin e institucioneve

MPJD: REAGIMI I SERBISË NDAJ NJOHJES SË KOSOVËS NGA SUDANI SHKEL MARRËVESHJEN E BRUKSELIT

F. 6



OSMANI: E KEMI GATI LIGJIN PËR HEQJEN E TARIFAVE NDAJ SHBA-SË, POR DUHET KONSTITUIMI I KUVENDIT

F. 3



NGA DUHET TË VIJNË PARATË PËR MBROJTJEN E EVROPËS?

F. 2

KALLASI PARALAJMËRON VIZITË NË KOSOVË DHE SERBI, KËRKON VAZHDIM TË DIALOGUT

F. 7

SVEÇLA THOTË SE ËSHTË ARRESTUAR EDHE NJË I DYSHUAR PËR DHUNËN NDAJ KFOR-it

F. 7

EKONOMI



ALIU: PËRMBYLLET ME SUKSES STUDIMI I FIZIBILITETIT DHE DIZAJNI PRELIMINAR PËR LINJËN HEKURUDHORE DURRËS - PRISHTINË

F. 8

ODA AMERIKANE I INKURAJON KUVENDIN DHE QEVERINË E RE TË MIRATOJNË NJË STRATEGJI KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

F. 8

SPORT



PRISHTINA DHE VËLLAZNIMI NË KËRKIM TË GJYSMËFINALES

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi ngrin fondet e universitetit Harvard

UASHINGTON, 15 PRILL - Universiteti elitar i Harvardit refuzon ta zbatojë ndryshimin e kursit të kërkuar nga presidenti Donald Trump si, për shembull, pranimin e studentëve në këtë universitet. Në një letër nga presidenti i universitetit, Alan Garber thuhet, se “asnjë qeveri - pavarësisht se cila parti është në pushtet - nuk duhet të diktojë se çfarë mund të ofrojnë si mësim universitetet private, kë mund të pranojnë dhe punësojnë, dhe cilat fusha studimi dhe kërkimi mund të ndjekin”. Universiteti i Harvardit nuk do të heqë dorë nga pavarësia dhe të drejtat e tij kushtetuese. Garber ka thënë më tej se liria e mendimit dhe e kërkimit shkencor, si dhe angazhimi shumë i gjatë i qeverisë për t'i respektuar dhe

mbrojtur këto liri, u kanë mundësuar universiteteve të kontribuojnë në mënyrë vendimtare për një shoqëri të lirë.

Qeveria e Trumpit ngrin miliarda

Kjo ka pasoja financiare për universitetin. Administrata amerikane reagoi menjëherë dhe njoftoi se tani do t'i shkurtojë fondet federale prej 2.2 miliardë dollarësh amerikanë (rreth 2 miliardë euro) për universitetin e njohur botëror. Edhe fondet nga kontratat ekzistuese që arrijnë në 60 milionë dollarë amerikanë (rreth 53 milionë euro) do të ngrijnë, po ashtu. Kjo masë u

argumentua me mospërfilljen me gjasë të të drejtave qytetare dhe përpjekje të pamjaftueshme kundër antisemitizmit në universitetin e njohur. Në një deklaratë nga Departamenti Amerikan i Arsimit thuhet se “deklarata e sotme e Harvardit përforcon mentalitetin shqetësues pretendues të të drejtës që është përhapur në universitetet dhe kolegjet më prestigjioze të vendit tonë”.

Çfarë ka kërkuar qeveria amerikane nga Harvardi?

Qeveria e Trumpit i kishte kërkuar universitetit, me qendër në Kembrixh, në shtetin Massachusetts, në një letër të



premtën, të bënte ndryshime dhe të plotësonte disa detyrime. Në kërkesën nga qeveria kërkohej që universiteti të raportojë mbi studentët e huaj tek autoritetet federale në rast të shkeljes së rregullave të sjelljes. Ta shqyrtonte diversitetin e qëndrimeve mes studentëve dhe stafit të universitetit. T'i

jepte fund pranimi të studentëve dhe rekrutimit të stafit bazuar në kriteret e diversitetit. Programi i diversitetit u vendos për t'i luftuar disavantazhet historike që kishin ekzistuar, për shembull, kundër njerëzve me ngjyrë ose grave, raporton la/dpa.

Nga duhet të vijnë paratë për mbrojtjen e Evropës?

Evropa duhet t'i forcojë kapacitetet mbrojtëse dhe ushtarake, por si duhet të financohen këto shpenzime? Sugjerimet janë të ndryshme

BRUKSEL, 15 PRILL - ShBA-ja mban deri tani pjesën më të madhe të koston e financimit të NATO-s, një aleancë ushtarake që bashkon 32 vende. Dhe siguria evropiane varet nga ushtarët amerikanë dhe armët e tyre në masë të madhe - domethënë nga aftësitë speciale ushtarake që evropianët nuk i kanë ende në dispozicion. Për shembull, në transportin ajror të tankeve apo trupave, por edhe të zbulimit dhe vëzhgimit satelitor. Që evropianët të jenë në gjendje të mbrohen kundër Rusisë pa mbështetjen amerikane, do të nevojiten 250 miliardë euro shtesë çdo vit (përveç shpenzimeve ekzistuese të mbrojtjes dhe armatimeve), sipas Institutit Bruegel me qendër në Bruksel dhe Institutit Kiel për Ekonominë Botërore. Konkretisht bëhet fjalë për 50 brigada me gjithsej 300 mijë ushtarë dhe 3 400 tanke të reja. Për krahasim: dërgimi i një brigade të re të vetme në Lituani (me rreth 5 000 ushtarë) e solli Bundeswehriin gjerman në kufirin e kapaciteteve ekzistuese.

Evropa me dy shpejtësi?

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të propozojë këtë javë një “zbutje” të rregullave strikte në lidhje me masën maksimale të borxhit kombëtar, që është përcaktuar me Traktatin e Mastrohit. Konkretisht, kjo do të thotë që qeveritë e vendeve



anëtare mund të investojnë miliarda euro shtesë në tanke, avionë luftarakë ose municione, pa llogaritur këto investime në deficitin e lejuar të parashkuar nga Traktati i Mastrohit. Kancelari Olaf Scholz e mbështet këtë propozim, i cili është në përputhje me qëndrimin e shpallur gjerman se mbrojtja duhet të mbetet në juridiksionin e autoriteteve kombëtare, pra që shpenzimet për armatim të financohen nga buxhetet e shteteve anëtare. Për ta përshpejtuar bashkëpunimin e sigurisë në Evropë, Qendra e Politikave Evropiane (EPC) me qendër në Bruksel sugjeron që 27 vendet e BE-së nuk duhet të përpiqen shumë për të arritur në vendime unanime, por në vend të kësaj që ato vende që duan ta bëjnë këtë duhet të ecin përpara më shpejt. Në këtë “koalicion të vullnetarëve”, siç thuhet, duhet të përfshihen edhe vendet që aktualisht nuk janë anëtare të Unionit, si Britania e Madhe apo Norvegjia. Këto vende do të paguanin para në një fond të përbashkët (Fondi Evropian i Financimit të

Sigurisë), dhe me fondet e përbashkëta, siç u tha më tej, mund të arrihet “efekti i levës financiare”. Duke bashkuar forcat, ne mund të marrim hua shumë më tepër sesa do të ishte e mundur me shumën e kapaciteteve tona individuale.

Borxhet e përbashkëta: po apo jo?

Franca, Spanja dhe Greqia duan që armatimet evropiane të paguhen me hua të përbashkëta evropiane, të cilat do të ndihmonin në shmangien e një barre shtesë mbi buxhetet e tyre kombëtare tashmë të mbingarkuara. Para së gjithash, është presidenti francez Emmanuel Macron ai që propozon krijimin e një fondi evropian të mbrojtjes ushtarake, i modeluar sipas fondit të BE-së për tejkalimin e pasojave të menaxhimit të krizave gjatë pandemisë së koronavirusit. Por ministri gjerman i Financave nuk është dakord. Edhe disa vende të tjera që praktikojnë disiplinë të rreptë buxhetore kanë rezerva të ngjashme. Këto

vende pëlqejnë një koncept ku shpenzimet e mbrojtjes do të mbeten përgjegjësi e qeverive kombëtare në të ardhmen. Megjithatë do të ishte krejtësisht e paqartë se vende si Spanja apo Italia, të cilat shpenzojnë më pak se 1.5 për qind të PBB-së së tyre për mbrojtje, mund t'i afrohen objektivit të shpallur të NATO-s prej 2 % të PBB-së në të ardhmen, veçanërisht kur e shikojmë në kontekstin e borxhit të tyre (shumë) të lartë shtetëror?

Armët e përbashkëta?

Deri më tani blerja e përbashkët e armëve ka qenë një përjashtim brenda BE-së. Pasojë e kësaj praktike është fakti se pesë herë më shumë sisteme të ndryshme të armëve përdoren në Evropë sesa në ShBA. Nga pikëpamja ekonomike do të ishte shumë më mirë të shpallej një tender për zhvillimin e armëve të reja, dhe këtë punë t'ia jepte koncernit që prodhon pajisje ushtarake dhe jep ofertën më të mirë. Nëse të gjitha ushtritë, për shembull, do të blinin një model tankesh të rënë dakord

paraprakisht, atëherë prodhimi i një numri më të madh tankesh do të ishte përfundimisht më i lirë (për copë). Ajo që duket të jetë një ide e mirë ekonomike, shpesh dështon për shkak të egoizmit kombëtar. Deri më tani Ministria e Mbrojtjes ka pëlqyer blerjen e sistemeve të prodhuara nga fabrikat vendase të armëve. Zbatimi i projekteve të përbashkëta do të vonohej për shkak të procesit të ndërlikuar të harmonizimit të pozicioneve. Sipas ekspertëve ushtarakë, prokurimi i përbashkët është, pavarësisht gjithë kësaj, diçka që ka potencialin më të madh për pajisjen më të mirë të ushtrisë me kosto të përballueshme.

Kredi të favorshme?

Anëtarë të shumtë të BE-së janë të bashkuar në vlerësimin e tyre se Banka Evropiane e Investimeve (EIB) duhet të miratojë kredi të favorshme për blerjen e armëve dhe municioneve. Deri më tani kjo nuk ka qenë në përputhje me statutet e BEI-së. Prodhimi i armëve mbështetet nga linja krediti vetëm në raste të jashtëzakonshme - në parim vetëm kur armët mund të përdoren edhe për qëllime civile, për shembull për satelitet ose dronë. “Zbutja” e këtyre rregullave mund të lejojë kompanitë e mesme në sektorin e armëve dhe të mbrojtjes në veçanti të “furnizohen” me kredi të favorshme.

OSMANI: E KEMI GATI LIGJIN PËR HEQJEN E TARIFAVE NDAJ SHBA-SË, POR DUHET KONSTITUIMI I KUVENDIT

PRISHTINË, 15 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Zyra e Presidencës ka bërë gati një ligj që do të mundësonte heqjen e tarifave prej 10-përqindësh ndaj mallrave të importuara nga ShBA-ja, por se për miratimin e tij duhet fillimisht të konstituohet Kuvendi i ri. “Ne e kemi gati ligjin që do t’ia propozojmë Kuvendit sapo të konstituohet. Kam diskutuar me shumë deputetë. Jam e bindur se do të kalojë”, tha Osmani në një intervistë për RTV 21.

Më 3 prill Osmani i kishte kërkuar qeverisë ta pezullojë tarifën doganore prej 10-përqindësh për mallrat nga ShBA-ja, një ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump kishte vendosur tarifë të ngjashme ndaj importeve nga Kosova.

Vendimi i Trumpit përfshinte tarifa ndaj shumicës së vendeve të botës me tarifë bazë prej 10-përqindësh, por më të lartë për vendet me të cilat ShBA-ja ka deficit tregtar. Por, ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, e kishte kritikuar qasjen e presidentes Osmani duke thënë se “politikat fiskale bien në fushëveprimin e ekzekutivit” dhe se këto çështje duhet të trajtohen larg medieve.

Kjo kishte nxitur reagim nga këshilltari për medie i presidentes Osmani, Bekim Kupina, i cili e kishte cilësuar përgjigjen e Muratit “të turpshme dhe skandaloze”. Osmani tha se kjo mosmarrëveshje mes institucioneve shtetërore të Kosovës e ka dëmtuar “interesin e Republikës së Kosovës jashtë mase”. “Ajo përgjigje ishte një dëm i madh për Kosovën, sepse Kosova e pat një momentum të jashtëzakonshëm që ta fuqizonte aleancën me Amerikën, në një moment kur për Amerikën ka qenë



esenciale se kush është shteti i parë që del me një propozim të tillë. Dhe unë kam qenë presidentja e shtetit të parë që kam dalë me atë propozim dhe ka qenë me rëndësi të dalim ne të parët”, tha Osmani.

Tarifa prej 10-përqindësh ndaj importeve të ShBA-së - si tarifë që Kosova ua vendos të gjitha vendeve me të cilat nuk ka marrëveshje për treg të lirë - është ende në fuqi, edhe pse Murati kishte thënë se qeveria ka qenë duke e

shqyrtuar heqjen e kësaj tarife për ShBA-në që një kohë të gjatë.

Ndërkohë, Osmani tha se ajo është duke punuar intensivisht me administratën e presidentit amerikan Donald Trump. “Ka një sërë hapash që tashmë i kemi ndërmarrë, që janë në proces e që për momentin nuk mund t’i bëj publike për shkak se janë duke u shqyrtuar nga administrata e Trumpit”, shtoi Osmani.

Ajo gjithashtu tha se shpreson

që Kuvendi i ri i Kosovës të konstituohet sa më shpejt, pasi që tha se është në interes të vendit. “Kosova ka shumë punë të cilat duhet të kryhen urgjentisht dhe Kuvendi është i domosdoshëm për një gjë të tillë. Prandaj mbes me shpresën që 15 prilli të jetë një ditë e suksesshme për gjithë Kosovën”, tha ajo.

LV-ja, që ka fituar 48 ulëse në Kuvend, e ka të drejtën ta propozojë kryeparlamentarin. Seanca konstituive, e caktuar për të martën, konsiderohet e

përmbyllur vetëm pasi të jenë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e deputetët e rinj të kenë bërë betimin. Për votimin e kryetarit kërkohen 61 vota. Vetëm pas kësaj, LV-ja do të mund t’i vazhdojë përpjekjet për ta formuar qeverinë e re, për të cilën kërkohen 61 vota. Megjithatë, më herët gjatë së hënës, ministri në detyrë për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq, deklaroi për gazetarët se nuk është optimist që të martën do të votohet për Qeverinë e re të Kosovës.

Osmani tha se Kosova ka nevojë për qeveri stabile, por se u takon partive politike e jo asaj të vendosë për këtë proces. Në intervistën për RTV 21, Osmani komentoi njohjen e fundit të pavarësisë së Kosovës nga Sudani, për të cilin Serbia kishte vënë dyshim mbi “kapacitetin e qeverisë aktuale të Sudanit për të marrë vendime me rëndësi jetike për marrëdhëniet ndërkombëtare”. Osmani tha se gjatë qëndrimit në Turqi, për Forumin e Diplomacisë në Antalia, janë arritur marrëveshje për njohje edhe me shtete të tjera. “Por, jemi dakorduar që procesi të formalizohet në vijim, [me shtete] të cilat nuk do të doja t’i përmend këtu për shkak se është me rëndësi që t’i mos i rrezikojmë ato procese”, tha Osmani.

Ndër këto shtete me të cilat Kosova po punon për të marrë njohje zyrtare të pavarësisë, Osmani e përmendi Sirinë. “Ne si institucione nuk kemi kërkuar marrëdhënie diplomatike asnjëherë me atë regjim [të Bashar al-Assadit], mirëpo tani me institucionet e Sirisë së lirë, natyrisht që shpresojmë që ky proces të konsolidohet dhe të përfundojë sa më parë”, tha Osmani.

Ritheksohet bashkëpunimi në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës

PRISHTINË, 15 PRILL - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletjtënant Bashkim Jashari, ka pritur në takim Agjutantin e Përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Ajovës (GKA), gjeneralmajor Stephen Osborn, i cili është duke zhvilluar vizitë zyrtare disaditore në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Fillimisht të dy gjeneralët diskutuan për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet FSK-së dhe GKA-së në kuadër të

Programit të Partneritetit Shtetëror (State Partnership Program). Diskutimi u fokusua në avancimin e bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe GKA-së si në trajnime, shkollime, stërvitje dhe në aktivitete të tjera të përbashkëta. Pastaj gjeneral Jashari i shprehu mirënjohje të veçantë gjeneralit Osborn për mbështetjen e ofruar nga GKA si partner strategjik bilateral për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së.

Në anën tjetër, gjeneral

Osborn falënderoi gjeneral Jasharin për leadershipin e tij në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, gjithashtu ritheksoi gatishmërinë e GKA-s për ta mbështetur FSK-në në rrugën e saj për zhvillim të mëtutjeshëm përmes ushtrimeve, trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta.

Në fund në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së u paraqit plani trevjeçar i sinkronizuar i aktiviteteve në mes të dy forcave drejt arritjes së objektivave të përbashkëta.





DËSHTON SEANCA E KONSTITUIMIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
PARTITË AKUZOJNË NJËRA-TJETRËN

KURTI VEÇ 52 VOTA, PO BLEN KOHË PËR T'I BËRË NUMRAT PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën konstituive nuk e kanë votuar raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit, duke bërë kështu që kjo seancë të ndërpritet. Komisioni para deputetëve paraqiti raportin dhe kërkoi që ai të votohej, me qëllim që të verifikoheshin mandatet 120 deputetëve të zgjedhur më 9 shkurt. Deputetët e LV-së dhe të Nismës kanë votuar për raportin. Kundër ishin ata të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së, ndërsa Lista Serbe abstenoj. Kurti, duke i akuzuar tri partitë që nuk e votuan këtë raport, ka theksuar se kjo është situatë e paparë në shtetin tonë e shumë më gjerë, ndërkaq partitë politike PDK, LDK dhe AAK kanë theksuar se Kurti po blen kohë, sepse nuk i ka votat për formimin e institucioneve

dhe kërkoi që ai të votohej, me qëllim që të verifikoheshin mandatet e 120 deputetëve të zgjedhur më 9 shkurt, në bazë të listës së certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Deputetët e LV-së dhe të Nismës Socialdemokrate kanë votuar për raportin. Kundër ishin ata të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së, ndërsa Lista Serbe abstenoj. “52 kanë votuar për, 46 kundër dhe 11 kanë abstenuar. Në bazë të kësaj, konstatojmë se raporti i Komisionit të Përkohshëm nuk kalon”, tha kryesuesi i seancës. Pasi dështoi kjo seancë, pati reagime nga partia fituese e zgjedhjeve, LV-ja, por edhe nga subjektet e tjera politike, PDK, LDK dhe AAK.

Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se deputetët e opozitës PDK, LDK, Lista Serbe dhe AAK votuan kundër raportit të Komisionit për Verifikimin e Mandateve. Sipas tij, kjo është situatë e paparë në shtetin tonë e shumë më gjerë. “Në një votim krejt formal e teknik që bazohet në dokumentacionin e KQZ-së, ata u rebeluan kundër betimit të deputetëve dhe konstituimit të legjislaturës së nëntë. Ky është sulm brenda institucional kundër Republikës së Kosovës dhe zgjedhjeve demokratike.

Kjo është situatë e paparë në shtetin tonë e shumë më gjerë. Ne qeverisim mbarë e mirë, këta lanë nam e bëjnë lajm të keq për shtetin tonë. Se janë kundër qeverisë e Republikës dihet, por se janë edhe kundër vetvetes, këtë e mësuam sot”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit në mënyrë që të mund të bëjë betimin e deputetit në legjislaturën e nëntë. Dorëheqje kanë dhënë edhe anëtarët e tjerë të Qeverisë në detyrë të Kosovës, që janë zgjedhur deputetë në zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se seanca për konstituimin e Kuvendit të Kosovës dështoi për dy arsye të vetme. “E para: Koalicioni VV-Guxo-Alternativa nuk e kishte shumicën e nevojshme parlamentare, sepse vetëm 52 deputetë votuan sipas kërkesës së tyre. E dyta: Insistimi i tyre për të mbajtur pozitat qeveritare dhe njëkohësisht për t'u betuar si deputetë, pa dhënë dorëheqje zyrtare, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Qeverinë, të cilin ligj e kanë hartuar vet”, ka shkruar

Krasniqi në “Facebook”. Ai ka thënë se në vend se të kërkojnë zgjidhje kundërkushtetuese për një situatë që e kanë krijuar vetë, është koha të sillen me përgjegjësi. “PDK-ja nuk do të mbështesë asnjë proces që bie ndesh me Kushtetutën, siç u tentua të ndodhte sot, andaj i ftojme qeverinë në detyrë, që: 1. Të japin dorëheqje zyrtare nga pozitat qeveritare; 2. Të vijin menjëherë në seancë që ta konstituojmë Kuvendin; 3. Pastaj vazhdojmë me fazat e tjera kushtetuese për themelimin e Qeverisë. Kosova ka nevojë për institucione të ligjshme, funksionale dhe të dala nga vullneti i qytetarëve - jo për improvizime jokushtetuese dhe lojëra politike që e vonojnë formimin e tyre. PDK-ja kërkon formimin sa më të shpejtë të institucioneve të reja dhe demokratike, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit”, ka thënë Krasniqi. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se apetiti i madh i deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe i prijësit të tyre për të qenë edhe kryeministër edhe deputet, prodhoj të martën një episod të errët demokratik në vend. “Jep dorëheqje zotëri, betohu si deputet! Si secili tjetër në

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 PRILL - Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës ka dështuar të martën pasi deputetët nuk e kanë votuar raportin e Komisionit për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit.

Kryesuesi i seancës, deputeti i LV-së, Avni Dehari, tha se do t'i drejtohen presidentes Vjosa Osmani se si të veprohet më tutje. “Për shkak të rrethanave të krijuara, meqë raporti i komisionit nuk mori votat e

mjaftueshme, në këto rrethana duhet ta ndërpresim seancën dhe me një letër ta njoftojmë presidenten sesi do të vijohet më tutje”, tha Dehari. Këshilltari për medie në Zyrën e presidentes së Kosovës, Bekim Kupina, tha të martën se “deri më tani nuk ka arritur asnjë letër nga Kuvendi”. “Para përgjigjes duhet të vijë pyetja”, shtoi ai, pasi u pyet për një deklaratë lidhur me atë që ndodhi në seancën konstituive të Kuvendit të Kosovës. Komisioni i përkohshëm para deputetëve paraqiti raportin

Kuvend! Mjaft më me filma e kauza plot mlllef! Të paprecedentë, sepse askush deri më tani, me mendje demokratike e me respekt ndaj Republikës, nuk kishte provuar t'i ketë të dyja funksionet përnjëherë! Derisa në njërin anë deklarojnë se po japin dorëheqje, në anën tjetër vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e dorëhequra sikurse s'ka ndodhur asgjë e re. Sa të pavërtetë; sa jodemokratik!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”, duke theksuar se e vërteta është krejt e thjeshtë. “Duan të blejnë kohë; sepse nuk kanë votë. Me 52 vota tani, ato që edhe i pamë. Pështyesit e moçalit të pështymave, nuk kanë shumicë. I duhet koha për pazare shtesë - të rënda, joparimore, të kushtueshme për këtë Republikë. Aq të kushtueshme sa u kuptua dhe nga mesazhet që i dërgonin njëri tjetrit vet!”, ka thënë Abdixhiku.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se konstituimin e Kuvendit e ka bllokuar vetë Albin Kurti. “Ligji e Kushtetuta e këtij shteti nuk lejojnë që të mbash edhe postin e Kryeministrit apo të Ministrit dhe të betohesh si deputet. Nuk mund të ulesh në dy karrige njëkohësisht. Ne nuk mund ta shkelim Kushtetutën dhe të veprojmë ndryshe, prandaj nuk e votuam raportin. Albin Kurti me ministrat e tij, nëse duan ta konstituojnë Kuvendin, le të tërhiqen ose nga postet ministrore, ose nga mandati i deputetit, e të mos i fajësojnë të tjerët për gabimet e veta”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

KDI: Kuvendi duhet të konstituohet, përgjegjësia kryesore bie mbi LV-në

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se me vetëm 52 vota për, të pamjaftueshme



për miratim, u dëshmuar qartë se ekziston një mospërputhje mes deklarimeve publike të Lëvizjes Vetëvendosje për sigurimin e shumicës së nevojshme dhe realitetit parlamentar. “Ndonëse të gjithë deputetët janë të obliguar të veprojnë në funksion të konstituimit të Kuvendit, mosdorëheqja formale e anëtarëve të qeverisë që kanë fituar mandat legjislativ ishte faktori kryesor që çoi në dështimin e sotëm të seancës. Në këtë kontekst, vlerësojmë se ky dështim nuk mund t'i faturohet vetëm opozitës, kur shumica pretendon se i ka votat, por është rezultat i keqmenaxhimit institucional dhe mungesës së përgatitjes ligjore nga ana e shumicës”, thuhet në reagimin e KDI-së. Sipas KDI-së, përpjekjet për

përfshirjen e presidentes për t'i dhënë drejtim procesit të konstituimit të Kuvendit, përveçse tërësisht të panevojshme, janë juridikisht të pavlefshme. “Roli dhe kompetencat e Presidentes përfundojnë me thirrjen e seancës - ndërsa menaxhimi i saj është përgjegjësi ekskluzive e kryesuesit të seancës, Avni Dehari”, thuhet në reagimin e KDI-së.

Sipas KDI-së, vazhdimi i seancës duhet të thirret sa më parë, brenda afatit 48-orësh, për ta mundësuar sërish mbledhjen e komisionit të përkohshëm, i cili duhet t'i shqyrtojë dhe verifikojë edhe një herë materialet përkatëse të cilat duhet të jenë të plota. “Më pas, është përgjegjësi e të gjithë 120 deputetëve që të votojnë pro raportit dhe të japin betimin. Në fund, LV, si

parti fituese, ka obligim të sigurojë votat e nevojshme për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit - përmes diskutimeve, negociatave dhe kompromisit politik - në mënyrë që të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për formimin e institucioneve dhe të shmangen zgjedhjet e reja”, theksohet në reagimin e KDI-së.

Cakolli kritikon mënyrën e dorëheqjes së kabinetit qeveritar, sqaron procesin

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës beson se ankesat e opozitës lidhur me mënyrën se si dhanë dorëheqje Albin Kurti dhe anëtarët e tjerë të kabinetit qeveritar, që janë zgjedhur

deputetë, janë të bazuara. “Dorëheqja e kryeministrit nuk është e mjaftueshme - çdo ministër që ka fituar mandat si deputet duhet ta dorëzojë dorëheqjen individualisht dhe në rrugë zyrtare”, thotë Cakolli. Ai thekson se nuk është e pranueshme që këto dokumente të dorëzohen në mënyrë informale apo përmes individëve të ndryshëm në ambientet e Kuvendit. Procedura e duhur përfshin dorëzimin zyrtar në Sekretarinë e Kuvendit, e cila më pas e përcjell dokumentacionin te komisioni përkatës. “Sepse unë besoj që nuk është e hijshme që këto të sillen nga individë të caktuar, të barten shkresat me dorë nëpër hollët e Kuvendit. Por, ka përcaktim të procedurave se si bëhet pranimi i një shkrese nga qeveria”, thotë Cakolli.

Enver Hasani: Opozita gaboi politikisht

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, aktualisht profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Enver Hasani, thotë Kuvendi i Kosovës nuk është bllokuar dhe mund të mbledhet çdo 48 orë, pasi deputetët dështuan ta konstituojnë këtë institucion. Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Hasani e cilëson gabim mosvotimin nga Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës të raportit të Komisionit për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit. Këto parti kanë vënë në dyshim dorëheqjen e paraqitur nga Albin Kurti dhe anëtarët e tjerë të qeverisë që janë zgjedhur deputetë. Por, Hasani thotë se me betimin e tyre deputetë, ata nuk do të mund të ushtronin asnjë funksion ekzekutiv.



MPJD: REAGIMI I SERBISË NDAJ NJOHJES SË KOSOVËS NGA SUDANI SHKEL MARRËVESHJEN E BRUKSELIT

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 PRILL - Kosova së fundmi ka pranuar njohjen nga Sudani, i cili është shteti i 119 me radhë që ka njohur pavarësinë e vendit tonë. Por ky vendim i Sudanit nuk i pëlqeu Serbisë. Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë tha se ky vendim është marrë në rrethana të “pasigurisë dhe mungesës së legjitimitetit të pushtetit”.

Ndaj kësaj deklarate ka reaguar Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës (MPJD). MPJD ka theksuar se deklarata e Ministrisë së Jashtme të Serbisë përbën një shkelje të qartë dhe të papranueshme të detyrimeve të Serbisë sipas Marrëveshjes së Brukselit të lehtësuar nga BE-ja në shkurt 2023 dhe Aneksit të Zbatimit të Ohrit të marsit 2023. “Republika e Kosovës, si një avokuese e palëkundur e paqes, dialogut dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, dënon fuqishëm deklaratën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Sudani. Kjo deklaratë përbën një shkelje të qartë dhe të papranueshme të detyrimeve të Serbisë sipas Marrëveshjes së Brukselit të lehtësuar nga BE-ja në shkurt 2023 dhe Aneksit të Zbatimit të Ohrit të marsit 2023. Më tej, kjo paraqet një përpjekje të papranueshme për të ushtruar presion ndaj qeverisë sovraane të Sudanit, duke cenuar të drejtën legjitime të këtij shteti për të marrë vendime të pavarura në kuadër të politikës së jashtme”, thuhet në reagimin e MPJD-së, duke theksuar më tutje se veprimet e Serbisë drejtpërdrejt bien ndesh me dispozitat kyçe të Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit. “Neni 1 i Marrëveshjes së Brukselit obligon të dy palët të



‘zhvillojnë marrëdhënie normale, fqinjësore të mira me njëra-tjetrën, mbi bazën e të drejtave të barabarta’. Duke kundërshtuar vendimin sovran të Sudanit për të njohur Kosovën, Serbia jo vetëm që dështon të përmbushë këtë obligim, por aktivisht punon për të penguar angazhimin ndërkombëtar të Kosovës. Për më tepër, Neni 4 i Marrëveshjes së Brukselit përcakton qartë se Serbia “nuk do ta bllokojë dhe as nuk do t’i inkurajojë të tjerët të bllokojnë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.” Aneksi i Ohrit e rithekon këtë dispozitë, duke nënvizuar detyrimin e Serbisë për t’i shmangur veprimet që pengojnë avancimin ndërkombëtar të Kosovës. “Reagimi i Serbisë ndaj njohjes nga Sudani përbën shkelje të drejtpërdrejtë të këtyre obligimeve dhe synon të ndalë përparimin e Kosovës drejt integritetit në komunitetin global”, theksohet në reagim. Sipas MPJD-së, ky nuk është një rast i izoluar. “Fushata e vazhdueshme e Serbisë për të penguar anëtarësimin e

Kosovës në Këshillin e Evropës tashmë është cilësuar nga Bashkimi Evropian si shkelje e Marrëveshjes së Brukselit, siç është reflektuar në deklaratat publike të kohës se fundit pas votës së Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në prill 2023. Zgjerimi i kësaj fushate në kontestimin e njohjeve bilaterale si ajo nga Sudani, zbulon sërish që Serbia përdor një strategji të qëllimshme për të minuar shtetësinë e Kosovës dhe ka një mospërfillje të vazhdueshme ndaj parimeve të dialogut konstruktiv dhe stabilitetit rajonal”, ka theksuar MPJD. Sipas Ministrisë së Jashtme të Kosovës, vendimi i Sudanit për ta njohur pavarësinë e Kosovës është politikisht i përgjegjshëm, historikisht i justifikuar dhe ligjërish i qëndrueshëm, në përputhje me Mendimin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të vitit 2010, i cili konstatoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkeli të drejtën ndërkombëtare. “Kjo njohje pasqyron konsensusin në rritje

global për shtetësinë e Kosovës, me 119 shtete që tashmë qëndrojnë në solidaritet me sovranitetin tonë. Përpjekja e Serbisë për të diskredituar vendimin sovran të Sudanit është jo vetëm shkelje e angazhimeve të saj në kuadër të dialogut, por edhe një fyerje ndaj sovranitetit të Sudanit dhe parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare. Republika e Kosovës shpreh mirënjohjen e saj të thellë ndaj qeverisë dhe popullit të Sudanit për qëndrimin e tyre parimor. Ne presim me padurim të vendosim marrëdhënie diplomatike dhe të eksplorojmë mundësitë për bashkëpunim në fusha me interes të përbashkët, të mbështetura në respekt dhe vlera të përbashkëta. Ne i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian dhe komunitetit ndërkombëtar që të adresojnë shkeljet e vazhdueshme të Serbisë dhe të sigurojnë zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit. Refuzimi i Serbisë për t’i nënshkruar formalisht këto marrëveshje, i

shoqëruar me deklaratat publike të vazhdueshme që mohojnë vlefshmërinë e tyre juridike ka mundësuar një model të vazhdueshëm moszbatimi. Kosova ka paralajmëruar prej kohësh për këtë rrezik dhe ka kërkuar vazhdimisht mekanizma formalë për të siguruar llogaridhënien”, ka theksuar MPJD.

Për më tepër, kjo ministri ka thënë se këto shkelje janë pjesë e një modeli më të gjerë dhe më shqetësues të sjelljes destabilizuese. “Akti i agresionit në Banjskë në shtator 2023, i cili rezultoi me vrasjen e zyrtarit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, si dhe sulmit kinetik ndaj infrastrukturës kritike në kanalin Ibër-Lepenc në nëntor 2024, ishin akte të qëllimshme për të destabilizuar Kosovën dhe rajonin. Këto veprime minojnë themelin e procesit të dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe përbëjnë kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Pavarësisht këtyre sfidave, Republika e Kosovës mbetet fuqishëm e përkushtuar ndaj dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe ndaj sigurimit të vendit të saj të merituar në bashkësinë ndërkombëtare si një partnere sovraane, e pavarur dhe e barabartë. Ne i bëjmë thirrje Serbisë të përmbushë obligimet e saj, të respektojë sovranitetin e shteteve të tjera dhe të ndalë të gjitha veprimet që pengojnë paqen, normalizimin dhe stabilitetin afatgjatë rajonal. Së fundi, i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian dhe aktorëve ndërkombëtarë që të forcojnë mekanizmat e mbikëqyrjes, me qëllim të garantimit të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit nga Serbia, duke ndërtuar një proces dialogu që çon drejt njohjes së ndërsjellë dhe paqes së qëndrueshme në rajon”, thuhet në reagimin e MPJD-së.

Shënohet 26-vjetori i betejës së lavdishme të Zhegotit

GJILAN, 15 PRILL - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla, mori pjesë të martën në manifestimin përkujtimor, me rastin e 26-vjetorit të Betejës së lavdishme të Zhegotit. Në këtë ditë përkujtimi dhe krenarie, në mesin e familjeve të dëshmorëve, bashkëluftëtarëve dhe qytetarëve, zëvendësministri Syla kujtoi me respekt të thellë dhe ndjenjë nderimi sakrificën e luftëtarëve të UÇK-së, që më 15 prill 1999 i dolën përballë

makinerisë serbe në mbrojtje të tokës, nderit dhe ekzistencës së popullit shqiptar. “Në ato ditë kur çdo kthesë e Anamoravës përshkohej nga pluhuri i kolonave ushtarake serbe, ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës ajo që u ngrit në mbrojtje të vendit. Ishin djemtë dhe vajzat tanë që në vend të heshtjes zgjodhën pushkën, në vend të dorëzimit zgjodhën qëndresën”, tha zëvendësministri Syla. Ai theksoi se amaneti i dëshmorëve nuk ishte vetëm

çlirimi, por ndërtimi i një shteti dinjitoz, të drejtë dhe të sigurt, dhe ky amanet po çohet në vend me përkushtim përmes zhvillimit të FSK-së dhe forcimit të aleancave ndërkombëtare, veçanërisht me shtetet anëtare të NATO-s. “Nëpërmjet familjeve të dëshmorëve flasin vetë dëshmorët. Në sytë e tyre rrezatojnë lavdia dhe qëndresa. Ata janë dëshmitarë të gjallë të një historie që as nuk harrohet, as nuk tjetërsohet”, u shpreh zëvendësministri Syla.




Osmani vlerësoi lart mbështetjen e Japonisë për Kosovën përmes agjencisë JICA

PRISHTINË, 15 PRILL - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Japonisë në Kosovë, Kiminori Iwama. Në takim është diskutuar edhe për zhvillimet e fundit në rajon dhe për sfidat e sigurisë. Presidentja Osmani e ka falënderuar Japoninë për mbështetjen e saj në promovimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

Presidentja Osmani ka vlerësuar lart mbështetjen e vazhdueshme të Japonisë përmes agjencisë JICA në shumë sfera. Në këtë kontekst, presidentja e ka informuar ambasadorin Iwama për vizitën bilaterale në Japoni, të planifikuar gjatë muajit qershor, si dhe pjesëmarrjen në EXPO 2025 në Osaka, në kuadër të kësaj vizite. Ajo ka theksuar se kjo vizitë do të përkohë me Ditën e

Çlirimit të Kosovës më 12 qershor, duke ofruar një mundësi të veçantë për ta promovuar Kosovën dhe për t'i forcuar lidhjet në mes dy shteteve. Më tej, presidentja ka nënvizuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, arsimit dhe shkëmbimeve kulturore, duke përmendur ndikimin pozitiv të bursave dhe programeve japoneze për të rinjtë e Kosovës.



KALLASI PARALAJMËRON VIZITË NË KOSOVË DHE SERBI, KËRKON VAZHDIM TË DIALOGUT

PRISHTINË, 15 PRILL - Shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, ka bërë me dije se do ta vizitojë Kosovën dhe Serbinë gjatë muajit të ardhshëm. Pas takimit të Këshillit për Punë të Jashtme në Luksemburg, Kallasi tha në një konferencë për medie se vizita do të vijë "më vonë në maj". "Sa iu përket Serbisë dhe Kosovës, është e qartë se normalizimi i marrëdhënieve të tyre është i rëndësishëm më të madhe. Për këtë arsye duhet të vazhdojë dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës", tha Kallasi. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, por ky aplikim ende nuk është shqyrtuar nga



autoritetet në Bruksel. Kosova, po ashtu, është e vetmja në rajon që nuk e ka statusin e shtetit kandidat. Për shkak të krizave në veriun e Kosovës, që

rritën tensionet mes dy vendeve, që nga shtatori i vitit 2023 në Bruksel nuk është zhvilluar asnjë raund i dialogut politik, por ka pasur vetëm

bisedime në nivel të kryenegociatorëve. Së fundi, Kallasi kishte thënë se BE-ja është e interesuar të shohë përparim drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, qoftë përmes dialogut apo ndonjë mjeti tjetër. "Ndoshta është dialogu, ndoshta është një tjetër mjet. Jam e gatshme ta shqyrtoj këtë çështje, dhe do ta bëj këtë së bashku me përfaqësuesin e posaçëm [për dialogun, Peter Sorensen] në ditët në vijim". Gjatë konferencës më 14 prill, Kallasi diskutoi edhe për procesin e zgjerimit dhe integrimin e mundshëm të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin

Evropian. Nga shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi - Kosova është e fundit sa i përket rrugëtimit të saj drejt BE-së pas aplikimit për anëtarësim në vitin 2022. "Nëse e shohim hartën, Ballkani Perëndimor është në Evropë në aspektin gjeografik. Duhet të jetë edhe në Bashkimin Evropian dhe për këtë arsye procesi i zgjerimit është shumë i rëndësishëm dhe duhet të ecim përpara me të", tha Kallasi. Ajo tha se Shqipëria dhe Mali i Zi po bëjnë hapa të mirë dhe se shpreson që këto dy shtete do të mund të merren si "histori suksesi".

SVEÇLA THOTË SE ËSHTË ARRESTUAR EDHE NJË I DYSHUAR PËR DHUNËN NDAJ KFOR-it

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se është arrestuar edhe një person që dyshohet se është përfshirë në dhunën kundër pjesëtarëve të KFOR-it në Zveçan më 2023. "Arrestohet edhe një nga terroristët që dhunshëm sulmoi pjesëtarët e KFOR-it në Zveçan, disa prej të cilëve mbeten me pasoja të përjetshme. Asnjë kriminel e terrorist nuk do ta ndjejë lirinë për aq kohë sa ka cenuar rendin tonë kushtetues, punën e institucioneve tona, detyrën e zyrtarëve tanë e personelit ndërkombëtar. Mbi ta do të

veprohet pa asnjë kompromis siç presim që edhe drejtësia të veprojë në linjë të tillë. Republika jonë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë zonë e rehatisë për kriminelë e terroristë", ka shkruar Sveçla. Më 29 maj të vitit 2023, 93 pjesëtarë të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, pësuan lëndime - disa edhe serioze - pas përleshjes me protestuesit serbë. Të lënduar nga kjo përplasje pati edhe në anën e protestuesve. Dhuna në Zveçan shpërtheu kur serbët lokalë kundërshtuan hyrjen e kryetarëve të rinj



shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna në veri të Kosovës, të

banuara me shumicë serbe, pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më herët po atë vit, që u bojkotuan nga serbët.

Kosova ka fajësuar Serbinë për ngjarjet në Zveçan, duke thënë se ato ishin kryer nga "grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq". Por, Serbia e ka mohuar një akuzë të tillë, duke e akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se synonte t'i shtynte serbët "drejt një konflikti me NATO-n". Deri më tani autoritetet e Kosovës kanë ngritur disa aktakuza ndaj personave të përfshirë në dhunën në Zveçan. NATO ka kërkuar që autorët e dhunës të mbahen përgjegjës.

Presidenti i Këshillit Evropian pritët ta vizitojë Kosovën në maj

PRISHTINË, 15 PRILL - Presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, pritët ta vizitojë Kosovën në muajin maj, pas një turi më të gjerë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Vizita është paralajmëruar nga Këshilli Evropian, por hollësitë e programit mbeten ende në përgatitje. "Po, edhe presidenti Kosta do ta vizitojë

Kosovën. Hollësitë e programit janë ende në përgatitje, kështu që nuk mund të konfirmojmë ndonjë specifikë për momentin", thuhet në një deklaratë të Këshillit Evropian. Gjatë një takimi të zhvilluar më herët me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, Costa theksoi se integrimi i vendeve

të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian është mënyra më e mirë për të garantuar mirëqenie, paqe dhe stabilitet në rajon. Për këtë arsye, ai ka bërë me dije se do të zhvillojë një tur në të gjithë Ballkanin Perëndimor në mesin e muajit maj për ta riafirmuar përkushtimin e BE-së ndaj këtij procesi.



ODA AMERIKANE I INKURAJON KUVENDIN DHE QEVERINË E RE TË MIRATOJNË NJË STRATEGJI KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 PRILL - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka bërë thirrje për vendosjen e zhvillimit ekonomik afatgjatë dhe fuqizimin e sektorit privat në qendër të agjendës së qeverisë së re. Në një njoftim zyrtar, Oda Ekonomike Amerikane thekson se Kosova ndodhet në një pikë kritike, ku nevojitet një strategji e guximshme, koherente dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, duke shtuar se vetëm përmes një vizioni të unifikuar mund të arrihet “rritje e qëndrueshme dhe qëndrueshmëri më e madhe ekonomike”. Oda Amerikane kërkon miratimin e një Strategjie Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik, që do të përfshinte bashkëpunimin mes institucioneve publike, sektorit privat, shoqërisë civile dhe

partnerëve ndërkombëtarë. Kjo strategji, sipas Odës, duhet të adresojë çështje kyçe si promovimi i investimeve, zhvillimi i kapitalit njerëzor, digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës. “Oda Amerikane inkurajon fuqishëm Kuvendin dhe Qeverinë e re që të miratojnë një strategji kombëtare të zhvillimit ekonomik, e cila bashkon institucionet publike, sektorin privat, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë rreth objektivave të përbashkëta. Kjo strategji duhet të jetë gjithëpërfshirëse në fushëveprim, duke adresuar aspektet kyçe si promovimi i investimeve, diversifikimi i energjisë, zhvillimi i kapitalit njerëzor, rritja e eksportit dhe modernizimi i infrastrukturës, duke siguruar njëkohësisht parashikueshmërinë rregullative dhe fiskale. Vetëm përmes një vizioni të tillë të unifikuar



Kosova mund të përparojë drejt rritjes së qëndrueshme dhe qëndrueshmërisë më të madhe ekonomike”, thuhet në njoftim. Në njoftim theksohet rëndësia e forcimit të dialogut publiko-privat, që garanton se politikat ekonomike pasqyrojnë realisht nevojat e bizneseve dhe ndërtohen përmes konsultimeve gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, Oda bën thirrje për

dizajnimin e mekanizmave të mbështetjes financiare për rritjen e eksporteve dhe avancimin e startup-eve. “Digjitalizimi i ndërmarrjeve private duhet të jetë prioritet për arritjen e një aftësie konkurruese afatgjatë”, thuhet në njoftim. Një pjesë thelbësore e rekomandimeve është edhe domosdoshmëria për reformë

fiskale dhe siguri juridike. “Qeveria e re duhet të ketë prioritet krijimin e një mjedisi të drejtë, transparent dhe të parashikueshëm fiskal”, thekson Oda, duke shtuar se politikat tatimore duhet ta “inkurajojnë formalizimin dhe stimulojnë inovacionin.” Në fund, Oda Ekonomike Amerikane propozon krijimin e një partneriteti ekonomik strategjik ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, si dhe thekson rolin e diasporës së Kosovës në zhvillimin ekonomik të vendit. “Diaspora e Kosovës ka jo vetëm kapitalin financiar, por edhe ekspertizën e gjerë, rrjetet dhe qasjen në tregjet e ndryshme të botës”. Po ashtu, është theksuar domosdoshmëria e reformimit dhe fuqizimit të agjencive që promovojnë eksportin dhe investimet në Kosovë, me qëllim që ato të veprojnë me “profesionalizëm, shpejtësi dhe qartësi strategjike”.

ZËVENDËSMINISTRI I FINANCAVE: E LASHË KONFERENCËN NË TIRANË SEPSE KOSOVËS IU VU FUSNOTA

PRISHTINË, 15 PRILL - Zëvendësministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Agon Dobruna, ka thënë se është larguar në mënyrë proteste nga një konferencë në Tiranë të Shqipërisë, pasi emri i Kosovës ishte shoqëruar me fusnotë. “Pavarësisht kërkesës sonë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për të korrigjuar këtë paraqitje, ajo u injorua, duke shkelur frymën e bashkëpunimit, respektit dhe barazisë që promovon vetë konferenca”, shkroi Dobruna në “Facebook”.

Konferenca për të cilën flet Dobruna ishte zhvilluar më 9 prill në Tiranë dhe ishte konferencë rajonale për kujdesin e fëmijëve. Në konferencën e titulluar “Përshejtimi i reformave të



kujdesit për fëmijët drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian” kishin marrë pjesë edhe përfaqësues nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, të pritur nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

Më 24 shkurt të vitit 2012, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje për përfaqësimin rajonal, që më vonë u bë e njohur si “marrëveshja e

fusnotës”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje fusnota do t'i shtohet emrit të Kosovës sa herë që vendi do të përmendej, për ta mundësuar përfaqësimin në konferenca e iniciativa të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. “Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj statusit dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për aktin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës”, thuhet në marrëveshje. Dobruna tha se prania e fusnotës e detyroi atë të largohet dhe e la pa nënshkruar deklaratën e angazhimit nga vendet e Ballkanit Perëndimor për bashkëpunim rajonal në fushën e të drejtave të fëmijëve.

“Përdorimi i fusnotës në këtë kontekst nuk është një çështje procedurale - është një çështje e dinjitetit kombëtar, e respektit dhe e trajtimit të barabartë, veçanërisht kur organizatori është një vend mik i Republikës sonë”, shkroi Dobruna në “Facebook”. Në vitet pas nënshkrimit të marrëveshjes, emrit të Kosovës i bashkëngjitej gjithnjë edhe simboli i fusnotës në dokumente të OKB-së, BE-së e institucioneve të tjera ndërkombëtare. Në vitet e fundit, megjithatë, në disa dokumente - si në rezoluta të Parlamentit Evropian, apo në dokumentet e Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi - fusnota nuk e ndiqte emrin e Kosovës.

Aliu: Përmbillet me sukses studimi i fizibilitetit dhe dizajni preliminar për linjën hekurudhore Durrës - Prishtinë

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministri në detyrë i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se është përmbyllur me sukses studimi i fizibilitetit dhe dizajni preliminar për linjën hekurudhore Durrës - Prishtinë. Aliu ka shkruar në “Facebook” se nga Durrësi në Prishtinë: një hekurudhë e re, një epokë e re për Kosovën dhe Shqipërinë. “Përmbillet me sukses studimi i fizibilitetit dhe dizajni preliminar për linjën hekurudhore Durrës-

Prishtinë, një projekt strategjik që na afron më shumë me Shqipërinë dhe i hap rrugë një transformimi të madh ekonomik, social e mjedisor. Kjo linjë do të shërbejë si urë për njerëzit dhe bizneset, do të ulë kostot e transportit, dhe me portin e thatë në Prishtinë si zgjatje e portit Romano në Durrës, po krijojmë një nyje të re zhvillimi për të gjithë rajonin”, ka thënë Aliu. Ai ka thënë se “bashkë me zëvendëskryeministren e

Shqipërisë, Belinda Balluku, ministrin e financave Petrit Malaj, kryetarin e Bashkisë së Shkodrës, Benet Beci dhe kryetarin e komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, pamë prezantimin e studimit të fizibilitetit dhe dizajnit preliminar për këtë linjë hekurudhore”. “1.8 miliard euro investim, rreth 105 km hekurudhë, 14 tunele, 7 stacione, dhe një vizion i përbashkët i Shqiptarisë që po bëhet realitet”, ka thënë Aliu.



IN MEMORIAM: MARIO VARGAS LLOSA (1936-2025) – E JETOI JETËN SIÇ DESHI DHE, MBI GJITHÇKA, E DASHUROI LETËRSINË

Nga: Nick CAISTOR, gazetar dhe përkthyes / The Guardian

Shumë shkrimtarë nga Amerika Latine janë tunduar të marrin një rol publik, por pak prej tyre e kanë ndjekur këtë ambicie aq shumë sa autori peruan Mario Vargas Llosa, i cili në vitin 1990 ishte shumë pranë zgjedhjes si president i vendit të vet. Vargas Llosa, i cili ka ndërruar jetë në moshën 89-vjeçare [më 13 prill 2025], kishte mundësinë për një post të lartë politik falë romaneve të tij të cilat e vendosën në radhën e parë të shkrimtarëve botërorë për më shumë se 50 vjet.

Veprat e tij të hershme, si Shtëpia e gjelbër [La Casa Verde, 1966] apo Biseda në katedrale [Conversación en La Catedral, 1969], e konsoliduan si një nga autorët kryesorë të asaj që më vonë u quajt shkolla e “realizmit magjik”, ndonëse në rastin e tij kjo kishte më shumë të bënte me teknikën narrative sesa me një këndvështrim magjik mbi historinë e vendit të tij. Ai zhvilloi gjithashtu një damar komik, më së shumti i vërejtshim te Halla Hulia dhe skenaristi [La tía Julia y el escribidor, 1977], që e veçoi edhe më tej nga shkrimtarët e tjerë të të ashtuquajturit “bum” të letërsisë latine-amerikane.

Vargas Llosa ka thënë se dëshira për të shkruar i lindi nga rrethanat e pazakonta që shoqëruan fëmijërinë e tij. I lindur në qytetin jugor peruan të Arekipës, ai u dërgua nga gjyshi, së bashku me nënën e tij Dora Llosa dhe vëllezërit e motrat, për të jetuar në Bolivi, pasi babai i tij, Ernesto Vargas, e braktisi familjen. I riu Mario u rrit duke besuar se i ati kishte vdekur.

Kur ishte 10 vjeç, nëna e tij e prezantoi me një të panjohur dhe i tha se ky ishte babai i tij. Ernesto u bashkua sërisht me familjen dhe ata jetuan së bashku në kryeqytetin e Perusë, në Lima. Duke e kujtuar këtë marrëdhënie të vështirë në autobiografinë e tij Peshku në ujë [El pez en el agua, 1993], Vargas Llosa foli për “inferioritetin shoqëror” që i ati ndiente ndaj nënës së tij, dhe këtë e quajti “sëmundja kombëtare ... që përshkon çdo shtresë dhe çdo familje në vend dhe ua lë të gjithëve një shije të keqe urrejtjeje, duke helmuar jetën e peruanëve në formën e mllëfeve dhe komplekseve shoqërore”.

Kompleksitetet e hidhura të jetës peruane iu bënë edhe më të dukshme Marios adoleshent kur, në moshën 14-vjeçare, u dërgua në një akademi ushtarake. Ai e urrente disiplinën e ashpër, por kjo eksperiencë i dha mundësinë të njihje njerëz nga shtresa dhe rajone të ndryshme. Përvoja u bë materiali themelor i romanit të tij të parë, Koha e heroit [La ciudad y los perros, 1963], dhe ndikoi në disa nga veprat e tij të mëvonshme.

Vargas Llosa e kishte të qartë tashmë se lavdia që e priste nuk ishte ajo ushtarake, por ajo letrare. Në moshën 16-vjeçare punoi si

reporter për rubrikën e krimeve në një gazetë ditore, dhe në moshën 19-vjeçare u arratis dhe në vitin 1955 u martua me kunatën e dajës që ishte goxha më e vjetër se ai, Julia Urquidi. Edhe këtë përvojë ai e shndërroi në literaturë, në romanin Halla Hulia dhe skenaristi, që fliste për një autor telenovelash radiofonike i cili e ka gjithnjë më të vështirë të dallojë realitetin nga krijimet e tij letrare. Ky ishte i vetmi nga librat e Vargas Llosas që tërhoqi vëmendjen e Holivudit. William Boyd, autori i skenarit për filmin e vitit 1990 (i njohur në ShBA si Bëhu gati për nesër / Tune in Tomorrow), e përshkroi veprën origjinale si “thuaje suiftiane, me një cilësi fantazie që e sheh botën si të stërngarkuar dhe absurde”.

Pasi u diplomua në Universitetin Kombëtar të San Markos në Lima, në vitin 1958, Vargas Llosa jetoi në Evropë, kryesisht në Barcelonë, Londër ose Paris. Në atë kohë, kryeqyteti francez ishte i mbushur me shkrimtarë të rinj nga Amerika Latine – përfshirë emrat si Gabriel García Márquez, Julio Cortázar dhe Carlos Fuentes – dhe ishin shtëpitë botuese franceze ato që krijuan për herë të parë “bumin” e letërsisë latine-amerikane. Romancieri i ri peruan u prit ngrohtësisht si anëtar i këtij klubi letrar.

Romanet e Vargas Llosas në këtë periudhë janë më afër traditës realiste sesa “realizmit magjik”, pasi ofrojnë përshkrime të mpërhta të niveleve të ndryshme të shoqërisë peruane. Magjia qëndronte në aftësinë e romancierit për të ndërthurur rrëfime dhe zëra të ndryshëm, pa lidhje të drejtpërdrejtë, duke krijuar një kompleksitet të pasur dhe duke shprehur një oreks të madh letrar.

Këto romane të hershme përmbanin një kritikë të gjerë ndaj gjendjes së shoqërisë peruane dhe, më gjerësisht, asaj latine-amerikane. Brezi i ri i shkrimtarëve e morrte dimensionin politik të veprës së tyre shumë më seriozisht dhe kuptohej gjerësisht se ata ndanin një pikëpamje të majtë. Mario shpejt filloi të shihje si person më ndryshe. Siç ndodhte shpesh, ishte revolucioni i Fidel Castros në Kubë ai që ndezi përplasjen. Kur doli revista Libre, një botim pan-latino-amerikan në Paris, nuk kaloi shumë kohë deri te momenti kur Vargas Llosa, García Márquez dhe të tjerë u përplasën mbi çështjen nëse duhej apo jo të mbështetej Castro.

Vargas Llosa mbajti vazhdimisht një qëndrim liberal dhe nuk e pranonte idenë se duhej bërë dallim mes vendeve në zhvillim dhe Evropës, ShBA-së apo demokracive të tjera përfaqësuese. Mbrojtja e tij e rreptë për këtë qëndrim ia solli shumë armiq në të majtë peruane dhe në Amerikën Latine në përgjithësi, ku shpesh është argumentuar se shkrimtarët duhet të jenë në anën e shumicës së varfër dhe të shtypur, duke u dhënë atyre zërin që u mohohet.



Gjatë dekadave në vazhdim, Vargas Llosa vazhdoi të publikonte romane që i sollën sukses dhe vëmendje në mbarë botën. Disa prej tyre, si Tregimtari [El Hablador, 1987] apo Vdekja në Ande [Lituma en los Andes, 1993], sugjerojnë se ai po përpiquej të ndërtonte një version peruan të koleksionit shumëvëllimësh të Balzacut, Komedia njerëzore [Comédie Humaine], duke përfshirë në veprat e tij gjithë shoqërinë peruane. Por, siç e bëri të qartë në veprën kritike Orgjia e përjetshme [La orgía perpetua. Flaubert y Madame Bovary, 1975], preferenca e tij personale ishte për mjeshttrin tjetër francez, Gustave Flaubert – për frymën e tij moderne, ndjenjën e ironisë dhe shqetësimin e thellë për gjuhën dhe stilin.

Reputacioni ndërkombëtar i Vargas Llosas bëri që qeveria peruane ta përfshinte drejtpërdrejt në çështjet politike të vendit. Në vitin 1983, atij i kërkojnë të ndihmojë në hetimin e vrasjes së tetë gazetarëve në fshatin e largët të Andeve, Uçurakai. Ngjarja ndodhi në kulmin e përplasjes mes guerilëve të Rugës së Ndritshme dhe forcave të armatosura peruane, dhe Vargas Llosa i zemëroi sërish të majtë në Peru dhe gjetkë, kur u pajtua me versionin zyrtar që thoshte se fshatarët kishin ngatërruar gazetarët me guerilët dhe i kishin vrarë ata – në vend që të ngulmonte se fajin e kishin forcat e sigurisë.

Kthimi i tij drejt liberalizmit të djathtë kishte lidhje edhe me leximet e tij të pangopura. Ishin historianët francezë si Fernand Braudel ata që e bindën se zhvillimi i tregjeve dhe mundësia për të tregtuar që në Mesjetë ishin thelbësore për natyrën njerëzore. Ai gjeti më tej një konfirmim të filozofisë së tij politike në karrierat e Ronald Reaganit dhe Margaret Thatcherit, të cilët shumë i admironte.

Edhe një herë, Vargas Llosa i përktheu këto bindje në veprim në vendin e tij, në Peru. Kur, në vitin 1986, qeveria populiste e majtë e udhëhequr nga Alan García shpalli synimin për të mos shlyer borxhin e vendit dhe për të shtetëzuar bankat, Vargas Llosa nisi një fushatë proteste në emër të lirisë individuale. Ishte një fushatë që ushqeu ambiciet e tij presidenciale. Në vitin 1989, ai u paraqit si kandidat i një spektri partish të djathta dhe qendrore, duke zhvilluar një fushatë mbi bazat konservatore të tregut të lirë.

Ai solli menaxherë fushate nga Britania dhe u përpoq të përdorte aftësitë e tij si shkrimtar dhe orator për të fituar mbështetjen e elektoratit peruan.

Fatkeqësisht, ishte e qartë gjatë mitingjeve të tij se, ndonëse mund ta kuptonte në mënyrë imagjinative realitetin e shtresave shumë të ndryshme të shoqërisë peruane, ai nuk dinte si t’u fliste drejtpërdrejt atyre. Megjithatë, ai fitoi shumicën e votave në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale dhe ishte i bindur se do ta fitonte edhe raundin e dytë kundër një agronomi të panjohur peruano-japonez, Alberto Fujimori.

Por, në javët mes dy rundeve të votimit, Fujimori fitoi gjithnjë e më shumë mbështetje nga peruanët e varfër, të cilët në figurën e Vargas Llosas – të bardhë, kozmopolit – panë të njëjtin lloj sundimtari që u kishte bërë premtime boshe për qindra vjet. Në fund, nuk ishte ndonjë befasi që Fujimori ishte ai që fitoi. Vargas Llosa u tërhoq nga politika, fillimisht i paafte për ta besuar se ishte refuzuar në atë mënyrë. Hidhërimi i tij doli në pah në romanin Vdekja në Ande (1993), në të cilin ai e portretizoi shoqërinë e Andeve të Perusë si aq të prapambetur saqë është e aftë edhe për kanibalizëm. Në të njëjtën periudhë, ai u tërhoq drejt një bote më intime letrare, duke eksploruar mundësitë e erotizmit në romanet Lavdi njerëkës [Elogio de la madrastra, 1988] dhe Shënimet e Don Rigobertos [Los cuadernos de don Rigoberto, 1997].

Edhe pse nuk ishte më i përfshirë drejtpërdrejt në politikë, Vargas Llosa përdori aftësitë e tij si gazetar për të sulmuar ashpër regjimin e Fujimorit, veçanërisht pas “auto-puçit” që presidenti organizoi në vitin 1992. Vargas Llosa u ankua se, si haknarrje, autoritetet ia shkatërruan shtëpinë në Lima. Kjo e shtyu atë të hiqte dorë nga shtetësia peruane dhe në vitin 1993 mori nënshetësinë spanjolle.

Festa e Cjapit [La Fiesta del Chivo, 2000] është kontributi i tij më i spikatur në traditën e gjatë të romaneve latine-amerikane që analizojnë abuzimet me pushtetin nga diktatorët e rajonit. Libri trajton diktatorin e Republikës Domenikane, Rafael Trujillo, dhe korrupsionin moral, seksual dhe politik që sjell sundimi autoritar. “Desha një trajtim realist të një qenieje njerëzore që u shndërrua në

përbindësh për shkak të pushtetit të grumbulluar dhe mungesës së kundërshtimit dhe kritikës ... I konvertuar në zot, bëhesh djall”, komentoi Vargas Llosa për atë që shumë e konsiderojnë si veprën e tij më të mirë.

Ai vazhdoi të eksploronte tema jashtë Amerikës Latine, por gjithsesi të lidhura me Perunë. Rruga për në Parajsë [El paraíso en la otra esquina, 2003] nuk trajtonte vetëm Paul Gauguinin në Tahiti, por edhe gjyshen e tij, Flora Tristan, një feministe e hershme revolucionare në Peru. Romani i tij i vitit 2010, Ëndrra e keltit [El sueño del celta], është një rrëfim i trilluar mbi jetën dhe vdekjen e Roger Casementit, pikëpamjet e të cilit mbi skllavërinë dhe kolonializmin u radikalizuan nga përvojat e tij gjatë qëndrimit në Amazonën peruane.

Në po atë vit, Vargas Llosa u nderua me Çmimin Nobel për Letërsinë. Fjalimi i tij i pranimit të çmimit ishte një mbrojtje e zjarrtë e letërsisë dhe leximit, duke theksuar se “pa letërsinë do të ishim më pak të vetëdijshëm për rëndësinë e lirisë që e bën jetën të jetueshme dhe për ferrin në të cilin kthehet kur kufizohet nga një tiran, ideologji apo fe”.

Më parë (në vitin 1994), ai kishte fituar edhe Çmimin Servantes, nderimi më i lartë për shkrimtarët në botën hispanike. Në vitin 2011, miqësia e tij me mbretin spanjoll Juan Carlos çoi në dhënien e titullit Markez për Vargas Llosan. Ai dhe Julia Urquidi u shkurorëzuan në vitin 1964, dhe një vit më pas ai u martua me kushërirën e tij, Patricia Llosa. Në vitin 2015, u nda prej saj dhe njoftoi publikisht lidhjen e tij me figurën e njohur të rretheve shoqërore, Isabel Preysler – një lajm që entuziazmoi revistat rozë. Romani i tij Lagjja [Cinco esquinas, 2018] është një rrëfim mbi shtresën e pasur të Perusë, që përfshin edhe shantazhin nga revistat e tilla. Marrëdhënia e tyre përfundoi në vitin 2023, me Vargas Llosan që deklaroi se dëshironte t’i përkushtohej më shumë letërsisë.

Romani i tij Kohë të vështira [Tiempos Recios, 2019] ishte i fundit që u përkthye në anglisht [me titullin Harsh Times, 2022]. Ai shqyrton një ngjarje historike – grushti i shtetit i mbështetur nga CIA kundër qeverisë së Guatemalës në vitin 1954 – nëpërmjet një rrëfimi të trilluar. Përveç romaneve, Vargas Llosa shkroi gjerësisht për teatrin dhe luajti në disa nga dramat e veta. Në një intervistë që më dha njëherë, kur e pyeta se çfarë do të dëshironte si epigraf në varrin e tij, ai u përgjigj: “E jetoi jetën plotësisht dhe mbi gjithçka dashuroi letërsinë”.

Nga martesë e tij e dytë ai lë pas një vajzë, Morganan, dhe dy djem, Álvaro dhe Gonzalon. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Korenica vazhdon formën e lartë në Rumani

Meriton Korenica ka barazimin 1:1 të skuadrës së vazhduar paraqitjet e mira në Rumani. Ai të hënën ndeshjes së katërt të plejofit mbrëma asistoi në ndeshjen e tyre në Clujit ndaj Rapid Bukureshtit në kuadër të për titull të kampionit në Rumani. Leonardo Bolgado shënoi gol në minutën e 87. Gjatë tërë takimit për Clujin luajti Lindon Emërllahu. Cluji është në vendin e dytë me 34 pikë, kurse Rapidin në vendin e gjashtë me 28.

Prishtina dhe Vëllaznimi në kërkim të gjysmëfinales

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - “Play-off”-i i ProCredit Superligës vazhdon të prodhojë ndeshje shumë interesante. Sfidat çerekfinale sollën dramë e adrenalinë deri në fund, derisa për t’u kualifikuar në gjysmëfinale duhet të zhvillohen edhe ndeshjet e treta. Seria çerekfinale është 1:1. Të mërkurën Sigal Prishtina ndeshet me Vëllazninin, në ndeshjen vendimtare për t’u kualifikuar tutje. Ndeshja e parë në kryeqytet përfundoi me fitoren e vendësve 71:69, edhe pse mysafirët po fitonin me katër pikë një minutë pa përfunduar sfidën. Ndërkohë, përballja tjetër në Gjakovë solli sërish adrenalinë, ku bardhekaltrit kishin epërsi deri në 21 pikë, por u përmbys nga kuqezinjtë që triumfuan 90:73. Në takimin tjetër ndeshen dy skuadrat verdhezi, Golden Eagle Ylli dhe Peja. Ndeshjen e parë e fituan pejanët në Therandë 71:77, të dytin në Pejë e fituan therandasit 66:75. Në gjysmëfinale kualifikohet skuadra që shënon dy fitore, derisa për finale duhen tri fitore. Për t’u shpallur kampion duhen katër fitore.



SHKURT

‘Marca’ lavdëron Muriqin

Gazeta e madhe spanjolle “Marca” i ka kushtuar një shkrim dyshe të sulmit të Mallorcas, Vedat Muriqi dhe Cyle Larin. Për Muriqin ka shkruar se “kosovari nuk po kalon një vit të mirë sa iu takon shifrave”. Tutje “Marca” ka shkruar se Muriqi gjatë këtij edicioni ka shënuar “një gol çdo 250 minuta”. 30-vjeçari ka shënuar shtatë gola dhe ka asistuar dy herë. Ka arritur shifrën e golave që i pati edicionin e kaluar, por Muriqi është larg 15 golave të shënuara në edicionin e parë në ishull. Muriqi është përballur me dy lëndime gjatë këtij edicioni. Sipas gazetës spanjolle, Muriqi mund të jetë jashtë fushës edhe për një muaj.

Rashica do të largohet nga Beshiktashi

Futbollisti Milot Rashica pritet të largohet nga Beshiktashi në fund të sezonit. Mediet në Turqi raportojnë se ylli “dardan” nuk bën pjesë në planet e trajnerit Ole-Gunnar Solskjaer, i cili tashmë ka dhënë miratimin për shitjen e sulmuesit të krahut në verë. 28-vjeçari këtë sezon ka shënuar 4 gola dhe ka bërë 9 asistime në 36 ndeshje për Beshiktashin, ekip me të cilin ka kontratë deri në verën e vitit 2027. Rashica ka luajtur edhe për Galatasarayn, Norwich Cityn, Werder Bremenin dhe Vitessen.

Lea Sylejmani ftohet nga Shqipëria

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Portierja Lea Sylejmani ka marrë ftesë nga Federata Shqiptare e Futbollit për grumbullimin e radhës të ekipit kombëtar të vajzave nën 19 vjeç. Lajmin e ka dhënë skuadra e 2 Korrikut nga Prishtina. Klubi kryeqytetas vlerëson se kjo ftesë ka ardhur pas punës së madhe që ka bërë talentja 16-vjeçare. “FC 2 Korriku me krenari njofton se portierja 16-vjeçare Lea Sylejmani ka marrë ftesë nga Federata Shqiptare e Futbollit për grumbullimin e radhës të ekipit kombëtar të vajzave nën 19 vjeç. Kjo ftesë, që është akt vlerësimi e mirënjohjeje për punën e talentes tonë, është një nga momentet që do të hyjë në historinë e klubit tonë, si një nga gjërat më të ndritura dhe të suksesshme. Me kënaqësi dhe krenari, FC 2 Korriku konfirmon se Lea Sylejmani do të lirohet në datat e caktuara nga ekipi kombëtar, dhe do të marrë pjesë në grumbullim, për çka i urojmë shëndet dhe suksese bashkë me të gjitha vajzat tjera që do ta përfaqësojnë kombëtaren shqiptare”, thuhet në njoftimin e 2 Korrikut.



Presidenti i Federatës Ballkanike të Gjymnastikës viziton Kosovën, pritët nga Krasniqi dhe Maqastena

Presidenti i Federatës Ballkanike të Gjymnastikës dhe i Federatës Turke Suat Çelen ka vizituar Federatën e Gjymnastikës së Kosovës dhe Komitetin Olimpik të Kosovës. Presidenti Suat Çelen është pritët nga kryetari i Federatës së Gjymnastikës në Kosovë, Shkumbin Maqastena, nënkryetarët Besim Halilaj, Sherife Aliqaj Qerimi dhe sekretari gjeneral Amir Tahiraga. “Pritje e ngrohtë është realizuar edhe në Komitetin Olimpik të Kosovës, ku takimi u zhvillua me presidentin Ismet Krasniqi dhe sekretarin gjeneral Besim Aliti. Gjatë takimit zyrtar presidenti Çelen dhe kryetari Maqastena u pajtuan për një bashkëpunim memorandum mes dy federatave”, thuhet në njoftimin e FGJK-së. Përfaqësuesit e Federatës së Gjymnastikës së Kosovës e falënderuan presidentin Suat Çelen për mundësitë e reja për bashkëpunim dhe për vizitën në vendin tonë.


Verstappen: Kemi probleme, por nuk i dimë cilat janë ato

LONDËR, 15 MARS - Shtatë ditë pas garës së jashtëzakonshme në Japoni, ku triumfoi me Red Bullin, piloti holandez Max Verstappen përjetoi një garë makthi të dielën e kaluar në Bahrein. Ai nuk ishte në gjendje të ndeshje jo vetëm

për fitoren, por as për podiumin. Vendi i gjashtë erdhi në xhiron e fundit, kur me një nga lëvizjet e tij, katër herë kampioni i botës në Formula 1 arriti ta parakalojë makinën Alpine të Pierre Gasly, e cila kishte qenë përpara tij gjatë pothuajse


tërë garës. “Gjithçka shkoi keq në Bahrein. Ne thjesht nuk kishim ritëm. Gomat po nxeheshin, ekuilibri ishte i keq. Kishim edhe disa pit-stop të këqija. Bilancimi i makinës në përgjithësi ishte i keq, menaxhimi i gomave ishte mjaft i dobët”, ka thënë

Verstappen. “Shpresojmë të mos kemi më gara të këqija si kjo dhe të shpresojmë se mund të bëjmë shumë më mirë në garën e radhës Jedah. Ne kemi probleme, por nuk e dimë se cilat janë realisht ato që t'i zgjidhim”, ka deklaruar piloti i Red Bullit.



Bayerni kërkon përmbysjen ndaj Interit, Arsenali ta ruajë rezultatin kundër Realit

MILANO, 15 PRILL (ER) - Sonte kompletohen katër skuadrat gjysmfinaliste në Ligën e Kampionëve. Bayern Munchen pësoi në ndeshjen e parë (1-2) ndaj Interit, por sulmuesi Harry Kane shpreh optimizëm se mund ta përmbysin këtë rezultat dhe të kualifikohen tutje. “Ishte një pikë e mirë ndaj një ekipi të fortë. Mendoj se pamë gjendjen para sfidës me Interin. Tani duhet t'i marrim ndeshjet një nga një, të japim gjithçka dhe më pas do të shohim se deri ku mund të shkojmë. Jemi gati për sfidën në ‘San Siro’. Duhet të jemi solidë, të bëjmë një ndeshje intensive dhe të krijojmë sa më shumë para portës. Interi ka një avantazh të lehtë, por mund t'i përmbysim dhe të kualifikohemi”, ka thënë Kane. Në anën tjetër trajneri Simone Inzaghi shpreh optimizëm, gjithashtu është i kujdesshëm për përballjen ndaj një kundërshtari shumë të fortë siç është Bayerni. “Nuk ka tension, por më shumë krenari për atë që po bëjmë këtë sezon. Në



ndeshjen e parë kemi bërë një paraqitje të shkëlqyer dhe duam ta përsërisim atë edhe në ‘San Siro’, megjithatë e dimë që do të jetë edhe më e vështirë. Bayerni nuk ka vetëm anësorë të fortë, por gjithë ekipin. Kanë një trajner të cilin e kam respektuar shumë edhe si lojtar, ndërsa në një kohë të shkurtër i ka dhënë skuadrës parimet e tij të lojës. Duhet të luajmë mirë teknikisht, për ta mbajtur sa më shumë topin. Ndeshja e parë u

interpretua shumë mirë, por duhet të jemi të kujdesshëm. Nuk ishte një finale, por pjesa e parë e një sfide të dyfishtë”, ka thënë Inzaghi. Në ndeshjen tjetër që zhvillohet në Madrid, Reali e pret Arsenalin që ka një epërsi të madhe nga ndeshja e parë (0-3). Kampionët në fuqi do të tentojnë ta përmbysin këtë rezultat, derisa Arsenali ta ruajë dhe të kualifikohet në gjysmëfinale. Të dyja ndeshjet fillojnë në orën 21:00.

FIFA dënon Shqipërinë

TIRANË, 15 PRILL - FIFA ka gjobitur Federatën Shqiptare të Futbollit pas sjelljes diskriminuese të tifozëve shqiptarë gjatë ndeshjes kualifikuese për Botërorin 2026 ndaj Andorrës, e zhvilluar në stadiumin “Arena Kombëtare” më 24 mars 2025. Komisioni Disiplinor i FIFA-s e konsideron të papranueshme sjelljen e tifozëve dhe ka vendosur një gjobë prej 20 mijë frangash zvicerane ndaj FShF-së si edhe mbylljen e të paktën 20 % të stadiumit në ndeshjen e radhës së Shqipërisë në kompeticionet e FIFA-s, me prioritet në tribunat pas portave. Sipas vendimit të dhënë nga FIFA, ky 20 % mund të mbushet me grupe të komunitetit ose organizata kundër diskriminimit, me miratim



paraprak nga qeveria botërore e futbollit. Gjithashtu, brenda gjashtë muajve FShF duhet të hartojë dhe të paraqesë një plan të përmirësuar kundër diskriminimit që duhet të miratohet nga FIFA. Federata u bënë thirrje tifozëve të vazhdojnë ta mbështesin Kombëtaren, duke krijuar

atmosferë të ngrohtë dhe pozitive dhe i fton të tregojnë qytetari dhe respekt përmes sjelljes korrekte ndaj ekipit kundërshtar, për të shmangur çdo situatë që mund ta dëmtojë ekipin kuqezi. FShF-ja mbetet në pritje të udhëzimeve të FIFA-s për mënyrën e zbatimit të vendimit.

SHKURT

Arteta: Titulli është i pamundur për Arsenalin

Trajneri Mikel Arteta dhe Arsenali duket se janë dorëzuar në garën për titullin kampion në Premierë Ligë. Ai ka thënë se diferenca me Liverpoolin kryesues është e madhe dhe as një mrekulli nuk mjafton. “Jemi të zhgënjyer me rezultatin. Kishim kontrollin e të gjithë ndeshjes, por pësuam një gol qesharak. Nuk ishte e mjaftueshme për të fituar edhe pse bëmë gjithçka. Donim t'i ruanim ende shanset për titullin kampion, por duket e vështirë. Me këtë rezultat është e pamundur. Nuk ka më shumë shpresë që të ndodhë, por ne duhet të shohim dhe të bëjmë maksimumin në Ligën e Kampionëve, pasi kemi një sfidë të vështirë në Madrid kundër Realit. Asgjë nuk ka përfunduar”, ka thënë Arteta.

Conte: Falë nesh kampionati ende është i hapur

Në Napoli të gjithë besojnë se mund të triumfojnë në Serinë A, fundja më të drejtë, në një kohë kur Interi është vetëm tri pikë larg, gjashtë javë përpara fundit. Ekipi i Antonio Contes arrin ta përballojë presionin, në sfidën e fundit, atë kundër Empolit, blutë iu përgjigjën në mënyrë të shkëlqyer duke fituar me rezultatin e pastër 3-0. “Jemi vetëm tri pikë larg Interit. Në fillim kjo dukej diçka e pamundur, por objektivi ynë ishte të ishim aty, ta bezdisnim Interin dhe do të bëjmë këtë deri në fund. Interi është një skuadër e kompletuar që po luan mirë edhe në Ligën e Kampionëve. Mbase dikush duhet t'i thotë Napolit faleminderit pasi po e mbajmë të hapur këtë kampionat. Nëse nuk do të ishim ne do të ishte mbyllur muaj më parë”, u shpreh Conte.

